

ARSIMI DHE DECENTRALIZIMI

Shkup, 2006



Arsimi dhe decentralizimi:

doracak i lehtë për përdorim

Autor:

Jovan Ananiev, magjistër

Projekt Menaxhmenti:

OSBE/Departamenti për Ndërtimin e Mirëbesimit/Njësia për Zhvillimin e Arsimit

Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të thotë se e përfaqëson edhe këndvështrimin dhe qëndrimin e Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup.

Foto:

OSBE/EDT

Botoi:

Vinsent Grafika - Shkup

Tirazhi: 3.000,

1300 (në maqedonisht),

600 (në shqip),

200 (në serbisht),

200 (në gjuhën rome),

200 (në turqisht),

500 (në anglisht)



Lexues të dashur,

OSBE-ja ka kënaqësi që po e lehtëson dhe përkrah procesin e decentralizimit në arsim, i cili është ndër pikat kryesore të tranzicionit në vend.

Shpresojmë që broshura mbi arsimin dhe decentralizimin do të jetë një mjet i çmueshëm dhe pikë referuese për subjektet e ndryshme kryesore të përfshira në procesin e arsimit në të gjitha nivelet.

Kjo broshurë ka për qëllim t'i shtojë dituritë dhe t'i qartësojë aspektet e ndryshme të procesit të decentralizimit, duke përfshirë komponentët juridikë, administrativ dhe fiskalë. Ajo merret me sqarimin vetë procesit dhe i përshkruan rolet dhe përgjegjësitë e subjekteve kryesore të përfshira në fushën e arsimit nga një bashkësi në një nivel qendror.

Uroj me dëshirat më të mira për implementimin e suksesshëm të procesit të decentralizimit në arsim.

Sinqerisht,
Ambasadori Carlos Pais
Shef i Misionit Vëzhgues të OSBE-së
në Shkup


Lexues të dashur,


Kemi kënaqësinë që t'juja prezantojmë broshurën mbi decentralizimin në arsim. Shpresojmë që ju atë do ta konsideroni si një mjet të çmueshëm dhe pikë referimi për veprimet tuaja.

Si një udhërrëfyese e lehtë për përdorim, ajo jep një pasqyrë të shkurtër të roleve dhe përgjegjësiave të subjekteve kryesore në procesin i cili sot në vendin tonë përfaqëson njëri nga sfidat më të ngutshme

Me pjesëmarrjen aktive të të gjitha subjekteve kryesore në procesin e vendimmarrjes në arsim, standardet evropiane mund të arrihen.

Sinqerisht Juaji
Z. Aziz Pollozhani
Ministri i Arsimit






Autori

Jovan Ananiev, magjistër i shkencave , partner i Institutit për Hulumtime Sociologjike, Politike dhe Juridike në Shkup. Ai punon në fushën e arsimit dhe të decentralizimit në bashkëpunim me institutet, fakultetet dhe organizatat e huaja ndërkombëtare.



Përmbajtja

Hyrje	9
Arsimi dhe decentralizimi	10
Arsimi fillor dhe i mesëm	11
Arsimi dhe decentralizimi fiskal	11
Rolet dhe përgjegjësitë e subjekteve kryesore	12
Niveli shtetëror	12
• Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe ministri	12
• Inspektorati Shtetëror i Shkencës	13
• Byroja për Zhvillimin e Arsimit	14
Niveli komunal	15
• Kryetari i Komunës	15
• Këshilli i Komunës	15
Niveli shkollor	15
• Këshilli i Shkollës	15
• Drejtori i shkollës	18
• Trupat profesionale shkollorë	19
Referenca	20





HYRJE

Decentralizimi synon që qytetarët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të përfshihen më shumë në procesin e vendimmarrjes në një numër më të madh të fushave, si: arsimi, planifikimi urban dhe rural, shëndetësia, kultura dhe zhvillimi lokal ekonomik. Pas miratimit të Ligjit të vetëqeverisjes lokale në vitin 2002, Republika e Maqedonisë e filloi këtë proces të sfidave të transferit të përgjegjësi nga niveli nacional në atë lokal/komunal.

Kështu duke filluar nga data 1 korrik, 2005, edhe arsimi i mesëm edhe ai fillor u vunë nën juridiksion komunal. Ky transfer, ndër të tjerash, nënkupton që komunat e kanë marrë përsipër pronësinë mbi godinat shkollore dhe pronat e tjera në lidhje me arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe përgjegjësitë e mirëmbajtjes së godinave shkollore dhe pagesën e rrogave për ndihmësit profesionalë. Me zhvillimin e mëtejshëm të procesit, komunat do të marrin përsipër edhe përgjegjësi plotësuese. Procesi i decentralizimit të arsimit përfshin pjesëmarrjen e shumë subjekteve kryesore, duke përfshirë drejtorët e shkollave, prindërit dhe nxënësit.

Fusha e arsimit fillor dhe të mesëm mbulohet nga Ligji i vetëqeverisjes lokale, Ligji i arsimit fillor dhe amendamentet e tij, Ligji i arsimit të mesëm dhe amendamentet e tij, Ligji i Inspektoratit Shtetëror dhe Ligji i financimit të njësive të vetëqeverisjes lokale.



ARSIMI & DECENTRALIZIMI

Arsimi paraqet një sektor kryesor në zhvillimin e çdo shoqërie. Qëllimi i decentralizimit në arsim është që të përmirësohet cilësia e standardeve arsimore, të ngrihet qasja në arsim dhe të përmirësohen nivelet e arritjeve akademike.

Procesi i decentralizimit u mundëson komunave të menaxhojnë me mjetet financiare të ndara për arsim dhe siguron një dallim më preciz të të drejtave dhe përgjegjësi të autoriteteve qendrore dhe lokale. Decentralizimi siguron një pjesëmarrje më të lartë të bashkësisë lokale në procesin e vendimmarrjes dhe një menaxhim më aktiv dhe më transparent të shkollave me përfshirjen e më shumë subjekteve të rëndësishme në procesin e vendimmarrjes. Ai siguron një kontroll më efikas të aktiviteteve të punës së shkollave dhe të cilësisë së mësimdhënies.

Brenda sistemit të arsimit fillor dhe të mesëm mund të identifikohen tre nivele : niveli qendror qeveritar (makroniveli), niveli lokal qeveritar (niveli i mesëm) dhe niveli shkollor (mikroniveli). Secili nivel i ka të drejtat dhe përgjegjësitë e tij.

Subjektet kryesore të makronivelet

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe trupat qeveritare që funksionojnë brenda kompetencave të saj, si Shërbimi Pedagogjik, Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Subjektet kryesore të nivelit të mesëm

- Këshilli i Komunës;
- Kryetari i Komunës
- Departamenti i arsimit (në disa komuna)¹ dhe inspektori i autorizuar komunal i arsimit (në disa komuna)².

¹ Varësisht nga vendimi i Këshillit komunal (Ligji i vetëqeverisjes lokale).

² Varësisht nga vendimi i Kryetarit të Komunës (Ligji i Inspektoratit Shtetëror Pedagogjik)



Subjektet kryesore të mikronivelit

- Këshillat e Shkollës,
- Drejtori,
- Këshilli i Arsimitarëve,
- Këshilli i Prindërve,
- Nxënësit.



ARSIMI FILLOR & I MESËM

Janë bërë disa ndryshime në fushën e arsimit fillor dhe atij të mesëm (Ligji i arsimit fillor, Ligji i arsimit të mesëm). Arsimi fillor shtrihet në nëntë vite dhe, sipas rregullës, është i obligueshëm për të gjithë fëmijët nga mosha gjashtë deri në pesëmbëdhjetë-vjeçare.

Arsimi i mesëm jepet në shkolla të mesme publike ose në ato private. Shkollat e mesme publike mund të themelohen nga komuna ose nga shteti³. Shteti mund të themelojë një shkollë të mesme për kategori të caktuara të nxënësve ose për fusha të interesit të posaçëm për shtetin (artë, muzikë, shkolla për fëmijë me të meta dhe shkolla të tjera të tilla të specializuara).

Arsimi parashkollor është i obligueshëm për të gjithë fëmijët (Ligji i arsimit fillor). Arsimi parashkollor është tani nën përgjegjësinë e komunës, ndërsa MASH-i është përgjegjëse për programet arsimore. Ndërkaq Ministria e Punës dhe Punëve Sociale (MPPS) nuk është më përgjegjëse për arsimin parashkollor⁴.

ARSIMI DHE DECENTRALIZIMI FISKAL

Procesi i decentralizimit shoqërohet me decentralizimin fiskal, i cili kryhet gradualisht në dy faza. Procesi i tillë imponon krijimin e një mekanizmi transparent për financimin e komunave të bazuar në kriterie dhe vlerësime objektive.

3 Shkollat e mesme private dhe ato të themeluara nga shteti nuk përfshihen në procesin e decentralizimit.

4 Foshnjoret janë po ashtu nën përgjegjësinë e komunave. MPPS është akoma kompetente për çështjet drejtuese dhe për kushtet në institucionet parashkollore deri në vitin 2007, kur ata do t'ua dorëzojnë komunave përgjegjësitë e mbetura.

Në bazë të raporteve financiare të përpiluara paraprakisht nga secila shkollë Ministria e Arsimit dhe Shkencës ndan mjetet për komunat. Këto raporte i dërgohen komunës dhe më pas komuna ia dërgon ato Ministrisë.

Faza e parë, e cila filloi në korrik 2005 dhe vazhdon për dy vite i përfshin të ashtuquajturat “subvencione të planifikuara” të cilat përfshijnë mjete për shpenzimet e riparimeve⁵ të shkollave fillore dhe të mesme dhe transportimin e nxënësve të shkollave të mesme⁶.

Faza e dytë do të fillojë në vitin 2007 dhe parasheh ndarjen edhe të “subvencioneve të planifikuara” dhe të të ashtuquajturave “bllok-subvencione”. Bllok-subvencionet parashikohen për fusha të posaçme nën përgjegjësinë e komunës, duke përfshirë arsimin, dhe do të përdoren për shpenzime, si rrogat për personelin mësimdhënës dhe profesional.

Ndarja e fondeve, duke përfshirë bllok-subvencionet, bazohet në një formulë dhe përcaktohet sipas fazave të decentralizimit fiskal. Formula bazohet në numrin e nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme në territorin e komunës.

Nën disenjimin e formulës, mund të konsiderohen edhe disa nga faktorët e mëposhtëm: : mosha e nxënësve, planet dhe programet e implementuara në shkollë, lloji i godinës së shkollës dhe lokacioni i shkollës.

ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E SUBJEKTEVE KRYESORE

NIVELI SHTETËROR

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe ministri i Arsimit dhe Shkencës

Ministri:

- i miraton standardet dhe normat pedagogjike (të propozuara nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit)

5 Çmimet (e tokës), ngrohja, rryma, komunikimet dhe transporti, materialet e shkrimit, detergjentet e higjienës, gazetat dhe revistat, riparimet vijuese etj.

6 Të gjithë nxënësit që jetojnë më larg se 2 kilometra nga shkolla fillore kanë të drejtë të mbulimit të shpenzimeve transportuese. Shkolla është përgjegjëse për pagesën.

- i miraton planet dhe programet për shkollat publike, që përgatiten nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit;
- e zgjedh një shkollë publike për të shërbyer si projekt pilot me qëllim që në plan-programe të inkuadrohen forma dhe përmbajtje të reja të aktiviteteve arsimore;
- i miraton projekt-tekstet mësimore (të përgatitura nga Byroja sipas planeve dhe programit të subjekteve përkatëse);
- vendos një komision për vlerësimin profesional të propozimeve për tekste mësimore për subjektet përkatëse;
- e miraton programin e provimeve për provimin përfundimtar nacional të shkollave të mesme, maturën, ose maturën ndërkombëtare në arsimin e mesëm (sipas propozimit të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit);
- i miraton politikat mbi format pedagogjike, procedurat dhe kushtet për stërvitje profesionale dhe pedagogjike;
- i autorizon dhe verifikon diplomat e lëshuara jashtë vendit;
- vendos një komision ekspertësh të përbërë nga përfaqësues të trupave profesionale të Ministrisë dhe të universiteteve për disenjimin e provimeve për drejtorë të shkollave;
- e mbikëqyrë bashkëveprimin juridik të implementimit të programeve shkollore të shkollave fillore dhe të mesme.

INSPEKTORATI SHTETËROR I ARSIMIT

Inspektorati Shtetëror i Arsimit është një organ i administratës shtetërore dhe ai funksionon brenda kornizës së Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Inspektorati e mbikëqyrë cilësinë e sistemit arsimor të institucioneve fillore dhe të mesme. Ai po ashtu e mbikëqyrë aplikimin e ligjeve relevante, rregullat e tjera dhe aktet e arsimit.

Kompetencat kryesore të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit përfshijnë: mbikëqyrjen e kryerjes së punës, përparimin profesional dhe pedagogjik, përdorimin e teksteve mësimore; menaxhimin e shkollës dhe të administratës, realizimin e plan-programit, realizimin e aktiviteteve jashtëprogramore, disenjimin e kriteve dhe analizimin e rezultateve të provimeve pranuese dhe mbajtjen e shënimeve pedagogjike.

Përveç Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, po ashtu ka edhe **inspektorë të autorizuar të arsimit** në disa nivele komunale⁷ dhe në Qytetin e Shkupit për arsimin e mesëm. Një inspektor i arsimit e mbikëqyrë legjitimitetin e aktiviteteve në fushën e arsimit për të cilën është kompetente komuna. Më saktë, inspektori i autorizuar komunal i mbikëqyrë kushtet dhe vendimet në lidhje me themelimin apo pushimin e aktivitetit të institucioneve arsimore, kushtet e punës në institucionet arsimore, përfshirjen e nxënësve në pajtim me themelimin e shkollave, transportin, ushqimin dhe vendosjen e nxënësve, procedurën për formimin e njësive të shkollës dhe kontrollimin e mjeteve të fituara nga burimet personale.

Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA)⁸

Byroja për Zhvillimin e Arsimit është organ brenda Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Përveç detyrave të kryera për MASH-in, BZHA-ja i kryen edhe këto detyra:

- studimi, hulumtimi dhe zhvillimi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- zhvillimi i plan-programit, standardeve arsimore, dokumente normative dhe dokumenteve të tjera programore;
- mbikëqyrja profesionale, sigurimi i instruksioneve dhe monitorimi;
- stërvitja profesionale e mësimeve dhe e menaxhmentit;
- vlerësimi i të arriturave të nxënësve;
- sigurimi i informatave, mbajtja e shënimeve, statistikat dhe publikimi i materialeve arsimore



⁷ Vendimi për të pasur një inspektor të autorizuar të arsimit të përcaktuar në nivel komunal bëhet nga prefekti (Ligji mbi Inspektoratet e Arsimit).

⁸ Hëpërhë, ligji për BpZhtA është në procesin e miratimit e sipër.

NIVELI KOMUNAL

Kryetari i Komunës:

- e cakton dhe/ose shkarkon drejtorin e shkollës me propozim të Këshillit të Shkollës;
- e miraton vendimin për të zgjedhur një drejtor të ri të shkollës tre muaj para skadimit të mandatit të drejtorit aktual dhe e fton Këshillin e Shkollës që të shpallë konkurs për këtë vend pune;
- e cakton një drejtor të ri brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas marrjes së propozimit nga Këshilli i Shkollës. Nëse për çfarëdo arsye drejtori nuk përcaktohet, e tërë procedura përsëritet dhe brenda pesë ditëve Kryetari i Komunës emëron një drejtor;
- në rast të shkarkimit të drejtorit, për jo më shumë se 6 muaj e cakton një tutor;
- e autorizon dikë që të veprojë si inspektor i arsimit⁹.

Këshilli i Komunës:

- E themelon dhe/ose e pushon shkollën;
- I informon gjyqet për vendimin e tij brenda tre ditëve prej miratimit të aktit;
- Siguron qasje në arsimin fillor dhe të mesëm për të gjithë fëmijët;
- Vendos për lokacionin e shkollës;
- I cakton anëtarët e Këshillit të Shkollës – dy anëtarë në shkollat fillore dhe tre në shkollat e mesme – për ta përfaqësuar në to pushtetin lokal.

NIVELI SHKOLLOR

Këshilli i Shkollës

Këshilli i Shkollës është njësi menaxhuese në shkollën fillore dhe në shkollën e mesme publike. Vendimet e Këshillit të Shkollës miratohen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

⁹ Nëse Kryetari i Komunës nuk e cakton një inspektor, kompetencat e këtilla do të kryhen nga Inspektori Shtetëror i Arsimit në llogari të komunës derisa të bëhet emërimi i tij/saj.

Këshilli i Shkollës në shkolla të vogla fillore¹⁰ përbëhet nga shtatë anëtarë: dy përfaqësues të arsimtarëve¹¹, edukatorëve¹² dhe të punësuarve profesionalë¹³, dy përfaqësues të prindërve/kujdestarëve të nxënësve, një përfaqësues i Ministrisë dhe dy përfaqësues të themeluesit¹⁴.

Këshilli i Shkollës në shkolla të mëdha fillore¹⁵ ipërbëhet nga nëntë anëtarë: tre përfaqësues të arsimtarëve, të punësuarve profesionalë dhe edukatorëve, tre përfaqësues të prindërve/kujdestarëve të nxënësve, një përfaqësues i Ministrisë dhe dy përfaqësues të themeluesit¹⁶.

Këshilli i Shkollës në shkolla të mesme publike¹⁷ përbëhet nga 12 anëtarë. Ata janë: katër përfaqësues të arsimtarëve, tre përfaqësues të prindërve/kujdestarëve të nxënësve, tre përfaqësues të themeluesit dhe nga një përfaqësues i Ministrisë dhe një përfaqësues i bashkësisë afariste. Përfaqësuesi i bashkësisë afariste merr pjesë në punën e Këshillit të Shkollës, por nuk ka të drejtë të marrë pjesë në votim dhe në marrjen e vendimeve.

Në Këshillin e Shkollës të:
shkollës fillore

- përfaqësues të themeluesit¹⁸ caktohen dhe suspendohen nga Këshilli i Komunës me propozim të Ministrisë;

shkollës së mesme

- përfaqësues të themeluesit¹⁹ caktohen dhe suspendohen nga Këshilli i Komunës, gjegjësisht nga Këshilli i Qytetit të Shkupit²⁰;
- rperfaqësues të bashkësisë afariste caktohen dhe suspendohen nga Oda Ekonomike.

10 Shkolla të vogla konsiderohen ato që kanë deri në 24 klasa.

11 Ka dallime ndërmjet arsimtarëve, edukatorëve dhe ndihmësve profesionalë. Arsimtarë janë ata që japin mësim në shkollat fillore dhe të mesme.

12 Edukatorët në sistemin fillor janë ata që punojnë me fëmijë që kanë nevoja të posaçme dhe ata që japin mësim në institucionet parashkollore, që është tani viti zero, vit i obligueshëm në arsimin fillor që u inkuadrua në vitin 2005.

13 Ndhimësit profesionalë përfshijnë pedagogët, psikologët dhe defektologët.

14 Ligji i arsimit fillor

15 Shkollat e mëdha kanë më tepër se 24 klasa

16 ibid (pranë titullit të lartpërmendur - sh. i përkthyesit)

17 Ligji i arsimit të mesëm.

18 Themeluesi i shkollës fillore është komuna.

19 Themeluesi i shkollës së mesme është ose komuna ose shteti.

20 Ky këshill është kompetent vetëm për shkollat e mesme në rajonin e Shkupit.

Në Këshillat e Shkollave të shkollave fillore dhe të mesme, të cilat themelohen nga komuna:

- përfaqësues të prindërve/kujdestarëve të nxënësve caktohen dhe suspendohen nga Këshilli i Prindërve;
- përfaqësues të arsimtarëve caktohen dhe suspendohen nga Këshilli i Arsimtarëve;
- përfaqësues të Ministrisë caktohen dhe suspendohen nga ministri.

Përgjegjësitë e Këshillave të Shkollave në shkollat fillore dhe shkollat e mesme komunale:

- e miratojnë statutin;
- ia propozojnë Këshillit të Komunës programin vjetor të punës dhe raportojnë mbi gjendjen e shkollës;
- ia propozojnë themeluesit planin vjetor financiar;
- ia propozojnë themeluesit bilancin vjetor të llogarive;
- lëshojnë një shpallje publike për zgjedhjen e drejtorit të shkollës;
- zhvillojnë intervista me kandidatët për drejtor të shkollës;
- i propozojnë Kryetarit të të Komunës një kandidat për vendin e punës drejtor shkolle;
- marrin vendime mbi ankesat dhe lutjet e të punësuarve të shkollës;
- marrin vendime mbi ankesat e nxënësve, prindërve dhe kujdestarëve;

Këshilli i Shkollës në shkollën fillore po ashtu i jep mendim drejtorit të shkollës rreth emërimit të arsimtarëve, ndihmësve profesionalë dhe edukatorëve.



Drejtori i shkollës

Drejtori i shkollës²¹ është organ udhëheqës i shkollës fillore dhe i shkollës së mesme publike dhe ai ose ajo është përgjegjës/e për bashkëveprimin juridik dhe për sigurimin e materialeve arsimore të shkollës.

Drejtori i shkollës organizon dhe udhëheq me aktivitetin arsimor, merr vendime, e përfaqëson shkollën para palëve të treta dhe është përgjegjës/e për bashkëveprimin juridik të punës së shkollës.

Drejtori i shkollës:

- e propozon programin vjetor të punës dhe ndërmerr masa për implementimin e tij;
- i ekzekuton vendimet e Këshillit të Shkollës;
- e bën zgjedhjen e arsimtarëve dhe të ndihmësve profesionalë dhe të personelit tjetër administrativo-logjistik;
- merr vendime për shpërndarjen e arsimtarëve, të ndihmësve profesionalë dhe të personelit tjetër administrativo-logjistik;
- merr vendime për anulimin e punësimit të arsimtarëve dhe të ndihmësve profesionalë;
- raporton para Byrosë për Zhvillimin e Arsimit për të arriturat e shkollës dhe rezultatet e arritura në aktivitetin arsimor në shkollë;
- i raporton Ministrisë dhe komunës për implementimin e programit vjetor.

Në përgjithësi, drejtori i shkollës është njëri nga aktorët më të rëndësishëm që siguron se fëmijët arsimohen. Ai ose ajo luan një rol kryesor në udhëheqjen e shkollës dhe në mbikëqyrjen e arsimtarëve gjatë aplikimit të aftësive të tyre të reja në mësonjëtoje.

21 Kohëzgjatja e mandatit të drejtorit të shkollës është gjithsej katër vite. Të gjithë kandidatët për postin e drejtorit duhet të kenë të paktën pesë vite përvojë në mësimdhënie dhe duhet ta kenë dhënë provimin për drejtorë. Një kandidat që nuk e ka dhënë këtë provim, mund të merret parasysh për këtë post vetëm me kusht që ajo/ai ta japë provimin brenda një viti të shërbimit si drejtor shkollë. Nëse ajo/ai dështon në dhënien e provimit, ajo/ai nuk do të ketë më të drejtë për atë post.

Trupat profesionalë shkollorë

Trupat profesionalë shkollorë po luajnë një rol të kufizuar në procesin e decentralizimit dhe të arsimit. Megjithatë, ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes në nivel të shkollës, për shembull, të veprojnë në emër të nxënësve.

Organet profesionale në shkollën fillore dhe të mesme janë: Këshilli i Arsimtarëve, Këshilli i Kujdestarëve të Klasave dhe Kujdestarët e Klasave.

Këshilli i Arsimtarëve përbëhet nga të gjithë arsimtarët, ndihmësit profesionalë, edukatorët dhe drejtori i shkollës. Këshilli i Arsimtarëve kryesohet nga drejtori i shkollës.

Kujdestari i Klasës caktohet nga Këshilli i Arsimtarëve të shkollës fillore me propozim të drejtorit të shkollës.

Këshilli i Klasave përbëhet nga kujdestarët e klasave ku zhvillohet aktiviteti arsimor, ndihmësit profesionalë dhe drejtori i shkollës. Këshilli i Klasave kryesohet nga drejtori i shkollës.

Grupi punues i ekspertëve është një trup ekspertësh që përbëhet nga një grup më i vogël arsimtarësh të cilët ligjërojnë në lëndën e njëjtë. Grupi punues i ekspertëve udhëhiqet nga një arsimtar i grupit të arsimtarëve.

Aktiviteti i organeve profesionale përcaktohet nga statuti i shkollës fillore dhe të mesme, në pajtim me Ligjin e arsimit fillor dhe Ligjin e arsimit të mesëm.

Në shkollat fillore dhe të mesme mund të themelojnë edhe trupa të tjerë profesionalë, si për shembull **Këshilli i Vitit**; përgjegjësitë e tij precizohen me statutin e shkollës.

REFERENCAT

- Ligji i vetëqeverisjes lokale, 2002
- Ligji i arsimit të mesëm, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004 dhe 55/2005
- Ligji i arsimit fillor, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 63/2004, 82/2004 dhe 55/2005
- Ligji i financimit e njësive të vetëqeverisjes lokale, 2002
- Ligji i Inspektoratit Shetëror të Arsimit, 2005
- Rregullat mbi metodologjinë e shpërndarjes së subvencioneve të planifikuara në arsimin e mesëm në komuna dhe në Qytetin e Shkupit, 2005
- Rregullat mbi metodologjinë e shpërndarjes së subvencioneve të planifikuara në arsimin fillor në komuna, 2005
- Doracak për zyrtarët e zgjedhur komunalë, BNjVL, 2005
- Strategjia për reformën e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë, BNVL, 1999
- Byroja për Zhvillimin e Arsimit, MASH, 2001

